VENDIM
Nr.1462, datë 5.11.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA BIBLIOTEKA KOMBËTARE, MUZEU HISTORIK KOMBËTAR, BASHKIA ELBASAN DHE ZYRA SHQIPTARE PËR TË DRJETAT E AUTORIT, SI AUTORITETE KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Bibliotekës Kombëtare të përfundojë, brenda datës 25 dhjetor 2008, procedurat e prokurimit, për rikonstruksionin e kësaj biblioteke, me fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2008, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Brenda këtij afati të përfshihet lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Lejimin e Muzeut Historik Kombëtar të përfundojë, brenda datës 8 dhjetor 2008, procedurat e prokurimit, për rikonstruksionin e këtij muzeu, me fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2008, sipas aneksit 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Brenda këtij afati të përfshihet lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publikimeve.

3. Lejimin e bashkisë Elbasan të përfundojë, brenda datës 8 dhjetor 2008, procedurat e prokurimit, për rikonstruksionin e Muzeut të Artit, me fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2008, sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Brenda këtij afati të përfshihet lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

4. Lejimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit të përfundojë, brenda datës 8 dhjetor 2008, procedurat e prokurimit, për blerjen e pullave, me fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2008, sipas aneksit 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Brenda këtij afati të përfshihet lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës të nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

5. Ngarkohen Agjencia e Prokurimit Publik, Biblioteka Kombëtare, Muzeu Historik Kombëtar, bashkia Elbasan dhe Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI NR.1

Procedurë e prokurimit publik, procedurë e hapur në mënyrë shkresore, me objekt "Rikonstruksioni i Bibliotekës Kombëtare", me fond limit me vlerë prej: 65.414.000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e katërqind e katërmbëdhjetë mijë) lekësh, pa TVSH.

Autoriteti kontraktor: Biblioteka Kombëtare

Lloji i punimeve: rikonstruksion

Zërat e punimeve, të ndara në kapituj:

1. Instalimi i rrjetit elektrik të ndriçimit
2. Instalimi i rrjetit elektrik të prizave
3. Instalimi i kuadrove elektrike
4. Instalimi i kablove elektrike
5. Instalimi i sistemit HVAC
6. Sistemi i kontrollit të hyrjeve
7. Impianti i ajrit të kondicionuar: furnizim dhe vendosje pajisjesh, tubacioni, rekorderi
8. Instalimet e brendshme: furnizim dhe vendosje pajisjesh
9. Tubacione, grila, aksesorë
10. Punime montimi
11. Punime ndërtimore rikonstruksioni.

Afati i përfundimit të rikonstruksionit të Bibliotekës Kombëtare: 65 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

ANEKS NR.2

Institucioni: Muzeu i Artit Elbasan, në lidhje me prokurimin e fondit në shumën prej:

13.500.000 (trembëdhjetë milionë e pesëqind mijë) lekësh, pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për "Realizimin e rikonstruksionit të Muzeut të Artit Elbasan", procedurë e hapur, e cila është parashikuar të zhvillohet më datë 5.11.2008.

Afati maksimal për lidhjen e kontratës parashikohet deri në datën 9.12.2008.

ANEKSI NR.3

Procedura e tenderit "Kërkesë për propozim", me objekt: "Blerje e jo më pak se 70 000 (shtatëdhjetë mijë) pulla artistike fonogrami–videogrami të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit".

Fondi i vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit me TVSH është 500 000 lekë, fondi limit që do të prokurohet pa TVSH është 420 000 lekë.

Mendojmë që njoftimi i kontratës në Buletinin e APP-së të bëhet në datën 3 nëntor 2008.

Hapja e tenderit të bëhet në datën 14 nëntor 2008.

Njoftimi i lidhjes së kontratës brenda datës 22 dhjetor 2008.

ANEKSI NR.4

Institucioni: Muzeu Historik Kombëtar, në lidhje me prokurimin e fondit në shumën prej: 18.184.215 (tetëmbëdhjetë milionë e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë) lekësh, pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për "Realizimin e pavionit etnografik pranë - Muzeut Historik Kombëtar", procedurë e hapur, e cila është parashikuar të zhvillohet në datën 5.11.2008, dhe afati i ekzekutimit të punimeve sipas projektit është 40 ditë nga lidhja e saj.

Afati maksimal për lidhjen e kontratës parashikohet deri në datën 9.12.2008.